



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 5 shkurt 2018
Nr. ref.: RK 1190/18

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI86/17

Parashtrues

Agron Alaj

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 6/2007,
të 15 majit 2017**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Agron Alaj nga Deçani (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson Tahir Rrecaj, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pml. nr. 6/2007, të 15 majit 2017, me të cilin është refuzuar, si e pabazuar, kërkesa e tij për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, nr. 351/2016, të 25 tetorit 2016, në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj, PKR. nr. 196/2015, të 10 majit 2016.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me paragrafin 2, të nenit 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), si dhe me paragrafin 1, të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ), nenin 10 të Deklaratës Universale, nenin 14 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, si dhe shkelja e parimit *in dubio pro reo*.
4. Parashtruesi gjithashtu kërkon nga Gjykata që “në pajtim me rregullin 39 të Regullores së punës (...), të caktojë seancë shqyrtuese”.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113. 7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 27 korrik 2017, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
7. Më 28 korrik 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Ivan Cukalović (kryesues), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.
8. Më 8 gusht 2017, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës si dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
9. Më 6 dhjetor 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 17 qershor 2014, Prokurori në Ferizaj (në tekstin e mëtejshëm: Prokurori) ngriti aktakuzën [PP. nr. 314-2/2012] kundër parashtruesit për shkak të dyshimit të arsyeshëm se ka kryer veprën penale krimi i organizuar në lidhje me veprat penale mundësimi i prostitucionit dhe shpëlarja e parave.

11. Më 10 maj 2016, Gjykata Themelore në Ferizaj (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore) [Aktgjykimi PKR. nr. 196/15] e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor dhe i shqiptoi dënimin unik me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) vitesh, si dhe dënimin me gjobë në shumë prej 50,000 euro.
12. Gjykata Themelore gjithashtu vendosi të konfiskojë nga parashtruesi i kërkesës pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme, të fituar nga kryerja e veprave penale për të cilat parashtruesi është shpallur fajtor.
13. Parashtruesi parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Themelore për shkak të *“shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale; vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike; shkeljeve të ligjit penal; konfiskimit të përfuturit material dhe vendimit për dënim”*.
14. Prokurori gjithashtu parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Themelore [PKR. nr. 196/15], për shkak të *“vendimit për konfiskim dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike”*.
15. Më 25 tetor 2015, Gjykata e Apelit [Aktgjykimi PAKR. nr. 351/2016] refuzoi të dy ankesat si të pabazuara, ndërsa Aktgjykimin e Gjykatës Themelore e vërtetoi në tërësi.
16. Parashtruesi parashtroi në Gjykatën Supreme kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, duke pretenduar shkeljen e ligjit penal, shkeljen e dispozitave të procedurës penale, vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe që aktgjykimi është i paqartë dhe kontradiktor.
17. Më 1 maj 2017, Gjykata Supreme [Aktgjykimi Pml. nr. 6/2017] miratoi pjesshëm kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë së parashtruesit përkitazi me cilësimin juridik të veprës penale të shpëlarjes së parave, ndërsa pretendimet e tjera, i refuzoi si të pabazuara.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i kontestuar i ka shkelur të drejtat e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe për barazi para ligjit, të garantuara me Kushtetutë dhe me marrëveshje dhe instrumente të tjera ndërkombëtare.
19. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë, sepse gjykatat e rregullta kanë shkelur dispozitat esenciale të Kodit Penal dhe të Kodit të Procedurës Penale, duke mos i vërtetuar faktet në mënyrë të plotë, duke mos i arsyetuar vendimet e tyre në lidhje me faktet vendimtare, duke mos dhënë përkufizim të saktë të veprave penale, duke i bazuar aktgjykimet në prova të papranueshme, dhe duke shkelur parimin *in dubio pro reo*.
20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se *“në të gjitha fazat e procedurës penale (...), parashtruesi iu nënshtrua shkeljes së një sërë të drejtave të garantuara*

me KPPRK, të cilat përfshijnë drejtpërsëdrejti shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe Instrumentet e tjera Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut. Gjykatat e rregullta nuk kanë arritur kurrë të korrigjojnë shkeljet e tilla gjatë fazës së apelit”.

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtës së tij për barazi para ligjit, për shkak të *“leximit gjatë shqyrtimit kryesor të deklaratave të dëshmitarëve të dhëna në procedurën paraprake pa miratimin e palëve”.*
22. Parashtruesi pretendon se neni 9 i KPK-së, parashikon që *“i pandehuri dhe prokurori i shtetit kanë statusin e palëve të barabarta në procedurën penale”.*
23. Parashtruesi kërkon nga Gjykata *“të konstatojë shkelje të drejtave individuale të parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 24 dhe 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (...)” dhe “ta shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 6/2017 të 15 majit 2017 dhe ta kthejë në rivendosje”.*

Pranueshmëria së kërkesës

24. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara me Ligj, dhe të parashikuara më tej me Rregullore të punës.
25. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

26. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar; kërkesa është dorëzuar në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit dhe se parashtruesi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike.
27. Megjithatë, Gjykata i referohet edhe nenit 48 të Ligjit [Saktësimi i kërkesës], i cili parasheh:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

28. Gjykata, më tej, i referohet rregullit 36 (1) d) dhe (2) b) të Rregullores së punës, i cili parashikon:

*“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:
[...]*

d) kërkesa arsyetohet *prima facie* ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese”.

29. Gjykata vëren se parashtuesi ankohet se vendimi i kontestuar nuk ka respektuar “standardet kushtetuese” të cilat “kërkojnë që argumentet e mbrojtjes të paraqiten dhe dëgjohen si ato të paraqitura nga prokurori”; “të garantojnë mundësinë e arsyeshme për secilën palë të paraqesin pretendimet e tyre për rastin (...) me qëllim që njëra palë të mos vihet në pozitë të pabarabartë me palën tjetër”; “të garantojnë vlerësimin e saktë dhe të barabartë të të gjitha provave dhe fakteve”; dhe “se aktgjykimi bazohet në provat e pranueshme të administruara gjatë shqyrtimit kryesor kur palëve në procedurë do t’u jepet mundësia t’i kundërshtojnë ato”.
30. Në këtë drejtim, Gjykata vëren më tej se pretendimet e parashtuesit për shkeljen e të drejtës së tij për gjykim të drejtë, në esencë, kanë të bëjnë me “shkeljen e një sërë të drejtave në të gjitha fazat e procedurës penale”. Si përmbledhje, parashtuesi pohon se procedurat në tërësi, duke përfshirë edhe procedurën e ankesës, ishin të padrejta dhe arbitrare.
31. Gjykata konsideron se pretendimet e parashtuesit, në esencë, reduktohen në pretendimin se është shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë.
32. Në të vërtetë, e drejta për gjykim të drejtë është një referencë e përgjithshme ndaj një kompleksi të të drejtave të tjera: përkatësisht, e drejta për prezumimin e pafajësisë, e drejta për një dëgjim të drejtë dhe publik, e drejta për kohë të mjaftueshme dhe ndihmë për t’u përgatitur mbrojtja, e drejta për të qenë i pranishëm në gjykim, e drejta për të thirrur dhe marrë në pyetje dëshmitarët, e drejta për të mbrojtur veten, e drejta për barazi para ligjit dhe gjykatave, e drejta për mbrojtës ligjor, e drejta për gjykim nga gjykata, e drejta për vendim të arsyetuar.
33. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton se në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës “Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.
34. Gjykata thekson që Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) konstatoi se “nuk është funksioni i saj të merret me gabimet e fakteve apo të ligjit, që pretendohet se janë kryer nga një gjykatë kombëtare nëse dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Konventë. Edhe pse neni 6 garanton të drejtën për një proces të rregullt gjyqësor, nuk vendos rregulla për pranueshmërinë e provave ose mënyrën se si ato të vlerësohen, që do të thotë se kjo është kryesisht çështje e rregullimit sipas ligjit kombëtar” (Shih, rasti i GJEDNJ-së, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28).

35. Gjykata vëren se parashtruesit të kërkesës i është mundësuar zhvillimi i procedurës bazuar në parimin e kontradiktoritetit e cila filloi në Gjykatën Themelore dhe vazhdoi në Gjykatën e Apelit deri në Gjykatën Supreme. Në fazat e ndryshme të këtyre procedurave ai ishte në gjendje të paraqiste të gjitha argumentet që ai i konsideronte të rëndësishme për rastin e tij. Gjykata Supreme shqyrtoi vendimet e mëparshme dhe përcaktoi gjerësisht arsyet faktike dhe ligjore për refuzimin e pretendimeve të tij si të pabazuara. Prandaj, parashtruesi i kërkesës nuk mund të pretendojë në mënyrë të vlefshme se argumentet e tij dhe parimi i barazisë së armëve nuk janë respektuar dhe se aktgjykimi nuk është i arsyetuar.
36. Në të vërtetë, Gjykata vëren se Gjykata Supreme shqyrtoi bazën e ankesës së parashtruesit të kërkesës për shkeljen esenciale të dispozitave të procedurës penale, përkatësisht argumentet mbi provat e papranueshme; pakuptueshmërinë, kundërshtimin dhe mungesën e arsyetimit në aktgjykime; mungesën e arsyeve të paraqitura në lidhje me faktet vendimtare; mungesën e përkufizimit të saktë të veprave penale dhe skadimin e afatit për ngritjen e aktakuzës.
37. Përveç kësaj, Gjykata vëren se Gjykata Supreme ka shqyrtuar gjithashtu bazën për shkeljen e Kodit Penal, përkatësisht argumentet e parashtruesit të kërkesës lidhur me faktin se aktet inkriminuese nuk ishin vërtetuar me asnjë dëshmi të vetme; Kodi Penal është zbatuar gabimisht dhe vendimi i gjykatës është arbitrar në lidhje me veprën penale të pastrimit të parave.
38. Gjykata konsideron se pretendimet, duke përfshirë të gjitha provat dhe vërtetimin e fakteve dhe kualifikimin ligjor të veprave penale, janë shqyrtuar tërësisht një nga një dhe janë arsyetuar në arsyetimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme.
39. Gjykata rikujton se është jashtë kompetencës së saj që të “konstatojë në abstrakt se dëshmitë e dhëna nga një dëshmitar në gjykatë të hapur dhe në betim duhet gjithmonë të mbështeten në preferencën ndaj deklaratave të tjera të bëra nga i njëjti dëshmitar gjatë procedurës penale, madje as kur ato dyja janë në kundërshtim me njëra tjetrën” (shih, GJEDNJ, rasti *Doorson kundër Holandës*, nr. 20524/92, 26 mars 1996, paragrafi 78).
40. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se vërtetimi i plotë i gjendjes faktike, si dhe interpretimi dhe zbatimi i ligjit, është në juridiksionin e plotë të gjykatave të rregullta dhe se roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm të sigurojë respektimin e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe me instrumente të tjera ligjore. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si “gjykatë e shkallës së katërt” (shih rasti i GJEDNJ-së, *Akdivar kundër Turqisë*, nr. 21893/93, 16 shtator 1996, paragrafi 65; shih, gjithashtu: *mutatis mutandis* rasti i Gjykatës Kushtetuese KI86/11, parashtruesi i kërkesës: *Milaim Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri i 5 prillit 2012).
41. Lidhur me këtë, Gjykata thekson se neni 6 i KEDNJ-së “garanton të drejtën për gjykim të drejtë, por nuk përcakton ndonjë rregull mbi pranueshmërinë e provave. Kjo është në radhë të parë një çështje e cila rregullohet me

legjislacionin e brendshëm” dhe se “si rregull i përgjithshëm, gjykatat vendore duhet t’i vlerësojnë provat e paraqitura para tyre. Detyra e Gjykatës sipas Konventës nuk është që të japë një vendim nëse deklaratat e dëshmitarëve janë pranuar si prova, por të konstatojë nëse procedurat në tërësi, duke përfshirë mënyrën në të cilën janë marrë provat, ishin të drejta (shih: rastet e GJEDNJ-së, Schenk kundër Zvicrës, nr. 10862/84, 12 korrik 1988, par. 46; dhe Teixeira de Castro kundër Portugalisë, nr. 44/1997/828/1034, 9 qershor 1998, paragrafi 34).

42. Përveç kësaj, Gjykata vëren se Gjykata Supreme konsideroi që *“mbrojtësi i të dënuarit edhe në këtë mjet juridik vetëm ka bërë përsëritjen e pretendimeve të paraqitura fillimisht në fjalën përfundimtare, më pas në ankesën kundër aktgjykimit të shkallës së parë dhe, tani në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë. Mbrojtësi më tepër i referohet fakteve, mënyrës se si janë vërtetuar ato dhe vlerësimit të provave, ndërsa në një pjesë dërmuese jep interpretimet e dispozitave ligjore në raport me prova të papranueshme - deklaratave të dëshmitarëve, e më pas jep edhe shpjegimet e tij rreth elementeve të veprave penale kurse pak jep shpjegime të cilat janë ato shkelje konkrete me përjashtim të disa pretendimeve, të cilat janë specifiku në kërkesën e tij për mbrojtjen e ligjshmërisë”*.
43. Gjykata gjithashtu konsideron se pretendimet dhe argumentet e ngritura para Gjykatës kanë të bëjnë me gabimet e fakteve dhe ligjit që pretendohet të jenë kryer jo vetëm nga Gjykata Supreme, por edhe nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata Themelore. Pretendimet dhe argumentet e paraqitura nga parashtuesi i kërkesës janë në esencë të njëjta me ato të paraqitura në Gjykatën Supreme. Duket se parashtuesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës Kushtetuese si të ishte një gjykatë e “shkallës së katërt”.
44. Gjykata konsideron se rezultati i procedurës së gjykatave të rregullta është i bazuar në vlerësimin veç e veç dhe të përbashkët të provave të paraqitura, në bazë të së cilit i kanë vërtetuar faktet për zbatimin e të drejtës materiale dhe vendimin për sanksionin penal.
45. Gjykata gjithashtu konsideron se parashtuesi nuk ka dëshmuar se konkluzionet faktike dhe ligjore të gjykatave të rregullta ishin në ndonjë mënyrë të padrejta dhe arbitrare dhe as nuk e ka vërtetuar pretendimin se *“ka pasur shkelje të një sërë të drejtave në të gjitha fazat e procedurës penale”*.
46. Gjykata konsideron se është obligim i parashtuesit të kërkesës që t’i dëshmojë pretendimet e tij kushtetuese dhe të dëshmojë shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese. Ky shqyrtim është në përputhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës (shih: rasti i Gjykatës Kushtetuese nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtues të kërkesës: *Tafil Qorri dhe Mehdi Syla*, i 5 dhjetorit 2013).
47. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se kërkesa e “drejtësisë” siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane, mbulon procedurat në tërësi; pyetja nëse një person ka pasur një gjykim “të drejtë” shikohet me anë të analizës kumulative të të gjitha fazave, jo thjesht një incident i veçantë ose mangësi procedurale; si rezultat, mangësitë në një fazë mund të korrigjohen në një fazë të mëvonshme (Shih rasti i GJEDNJ-së,

Monnell dhe Morris kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 9562/81; 9818/82, Aktgjykimi i 2 marsit 1987, paragrafët 55-70).

48. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e rastit të tij. Megjithatë, ky mospajtim nuk mundet vetvetiu të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkelje të Kushtetutës (shih rastin e GJEDNJ-së *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, kërkesa nr. 5503/02, Aktgjykim i 26 korrikut 2005).
49. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë fakt për të arsyetuar pretendimet për shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm; dhe as nuk i ka mbështetur ato pretendime siç kërkohet me nenin 48 të Ligjit.
50. Gjykata, më tej, konsideron se nuk mund të veprojë si “gjykatë e shkallës së katërt”.
51. Prandaj, kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (1) d) dhe (2) b) të Rregullores së punës.

Kërkesa për seancë publike

52. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata që të mbajë një seancë.
53. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 20 të Ligjit:

“1. Gjykata Kushtetuese vendosë mbi çështjen pas mbarimit të seancës së shqyrtimit verbal. Palët kanë të drejtë të heqin dorë nga shqyrtimi verbal.

2. Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, sipas vlerësimit të saj, gjykata mund të vendosë mbi çështjen që është objekt shqyrtimi kushtetues mbi bazën e shkresave të lëndës”.
54. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk është thirrur në ndonjë arsye për ta mbështetur kërkesën e tij.
55. Gjykata konsideron se dokumentet e përmbajtura në kërkesë janë të mjaftueshme për të vendosur për këtë kërkesë, sipas formulimit të nenit 20, paragrafin 2 të Ligjit (Shih, *mutatis mutandis*, rasti i Gjykatës Kushtetuese nr. KI34/17, parashtruese e kërkesës *Valdete Daka*, Aktgjykim i 12 qershorit 2017, paragrafët 108-110).
56. Prandaj, kërkesa e parashtruesit për mbajtje të seancës dëgjimore refuzohet si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) (d) (2) (b) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 6 dhjetor 2017, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Almiro Rodrigues



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi